



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF  
HEALTH

Raporti i llogarive nacionale të shëndetësisë për vitin 2017

Prishtinë,  
Shtator 2019

## Fakte rreth Kosovës


Republika e Kosovës ka një sipërfaqe prej 10 905.25 km<sup>2</sup>. Gjendet në pjesën e Evropës jug-lindore, e kufizuar me Shqipërinë në jug-perëndim, Malin e Zi veri-perëndim, Serbinë në veri-lindje dhe në jug me Maqedoninë. Territori shtrihet brenda gjerësive gjeografike 41° 51' dhe 43° 16', dhe brenda gjatësisë gjeografike 19° 59' dhe 21° 47'. Territori i Republikës së Kosovës karakterizohet me lartësi të ndryshme mbidetare. Pika më e ulët e Kosovës ndodhet në luginën e lumit Drini i Bardhë, në kufi me Shqipërinë dhe arrin lartësinë 270 m mbi nivelin e detit, e ajo më e lartë ndodhet në perëndim të Kosovës, në Gjeravicë - 2.656 m. Klima Republikës së Kosovës në pjesën më të madhe është kontinentale, duke rezultuar me verë të ngrohtë dhe dimra të ftohtë, me ndikime mesdhetare dhe kontinentale (temperatura mesatare brenda vendit luhet nga + 30 °C në verë, në - 10 °C në dimër). Megjithatë, për shkak të ngritjeve të pabarabarta në disa pjesë të vendit, ka ndryshime në temperaturë dhe shpërndarjen e reshjeve.

Aktualisht në Kosovë janë 38 komuna me 1.469 vendbanime të organizuara sipas ligjeve të vendit.


Shteti i Kosovës karakterizohet me strukturë shumë të re të popullsisë, ku moshë mesatare është 30.2 vjet. Pas vitit 1990 popullsia e Kosovës u përball me dukurinë e migracionit, i cili ndikoi si në strukturë ashtu edhe në ritmet e rritjes së sajë. Lëvizja e lirë dhe e pakontrolluar e popullsisë ka ndikuar në ndryshimin e raportit të popullsisë urbane me atë rurale. Sipas regjistrimit të popullsisë të realizuar në prill të vitit 2011, 61% e popullsisë jeton në zonat rurale.

Numri i banorëve për periudhën 1947- 2011, është llogaritur në bazë të rezultateve të regjistrimit të popullsisë (i cili zbatohet çdo 10 vite, sipas rregullave të Kombeve të Bashkuara), të dhënave të shtimit natyror të popullsisë dhe të dhënave në dispozicion për migracionin e popullsisë. Sipas përlllogaritjeve të bëra nga Agjencia e Statistikës së Kosovës, jetëgjatësia mesatare për vitin 2011 në Kosovë ishte 76.7 vite. Femrat kishin një jetëgjatësi mesatare prej 79.4 vite derisa, meshkujt 74.1 vite. Piramidat e popullsisë paraqesin strukturën e popullsisë sipas viteve të regjistrimeve, moshës dhe gjinisë. Deri në regjistrimin e fundit të vitit 2011, rezultatet janë prezantuar në bazë të konceptimit të popullsisë rezidente dhe jo rezidente. Ndërsa në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, nuk është përfshirë popullsia që jetonte jashtë Kosovës për më shumë se 12 muaj. Andaj për shkak të ndërrimit të metodologjisë, kemi disproporcion me numrin e përgjithshëm të popullsisë krahasuar me vitet e mëparshme. Projeksionet e popullsisë, paraqesin llogaritjen e ndryshimeve të ardhshme për numrin e popullsisë, pasi që janë supozime rreth tendencave të ardhshme në koeficientet e lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migracionit.

Grafiku 1: Piramida e popullsisë të datës 31 mars 2011 sipas gjinisë dhe moshës.  
(Burimi: ASK, 2019)



Grafiku 2: Popullata sipas moshës, 2018



Note: Bosnia and Herzegovina, not available.

(¹) 2017.

Source: Eurostat (online data code: [demo\\_pjangroup](#))

Sipas Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) për vitin 2016, konsumi i përgjithshëm në Kosovë në vitin 2016 ishte 2,3 miliardë Euro, ndërsa për ekonomi familjare 7 539 Euro, si dhe për kokë banori 1 460 Euro. Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare në vitin 2016 është shpenzuar për ushqim (42%) dhe për banim (29%). Pasojnë shpenzimet për veshmbathje me 5%, nga 4% për transport, alkool, duhan dhe për mobile dhe 3% për kujdes shëndetësor.

Shkalla e punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) për vitin 2016 ishte 28.0%. Punësimi me i lartë ishte te meshkujt 43.0% ndërsa punësimi te femrat ishte 12.7%. Sipas rezultateve të AFP-së për vitin 2016, shkalla e papunësisë është 27.5%. Papunësia më e theksuar është te femrat me 31.8%, krahasuar me meshkujt, 26.2%. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grup moshat 15-24 vjeçare me 52.4%. Kurse, fuqia joaktive është mjaft e lartë (61.3%) me fokus të veçantë te femrat me 81.4%, krahasuar me meshkujt (41.7%).

**(Burimi: Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës në Kosovë - 2016, IKSHPK).**

## Gjendja shëndetësore e popullatës në Kosovë - 2016

### Lindshmëria

Sipas ASK, gjatë vitit 2016, janë regjistruar 23 494 lindje, prej të cilëve të lindur gjallë 23 416 ndërsa 78 të lindur të vdekur. Indeksi vital është 253.3%. Në institucionet shëndetësore janë realizuar 23 427 lindje apo 99.7 %. (5,6);

### Vdekshmëria

Mortaliteti për vitin 2016 është vlerësuar 5.2‰. Sipas komunave, më i larti është në komunën e Parteshit me 19.8 ‰, Ranillugë 14.1‰ dhe Shtrpce 13.9‰.

Sipas komunave, mortaliteti më i ultë është regjistruar në komunën e Zubin Potokut me 0.5‰. Krahasuar nëpër vite, mortaliteti shënon trend të rënies me lëvizje variabile.

### Shtimi natyror

Shtimi natyror është 7.9 ‰. Indeksi vital është 265; Krahasuar nëpër vite, shtimi natyror shënon rënie me lëvizje variabile.

## Analiza e veprimtarisë shëndetësore

Kujdesi shëndetësor në Kosovë ofrohet në tri nivele. Nivelin parësor e përfaqëson mjekësia familjare. Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH) ka njësitë e veta në të gjitha komunat e Kosovës si 28 Qendra kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) me njësi të shërbimeve si qendrat e mjekësisë familjare QMF 183 dhe 191 Ambulanta të mjekësisë familjare (AMF). Në këtë numër të institucioneve shëndetësore të kujdesit parësor nuk janë përfshirë institucionet të cilat nuk raportojnë në institucionet shëndetësore të Kosovës.

Në Kosovë institucionet bazë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në nivelin dytësor të kujdesit shëndetësor janë spitalet e përgjithshme duke ofruar mjekimin stacionar si dhe shërbimet specialistike jashtë spitalore.

Shërbime specialistike ambulatorie dhe stacionare, popullatës i ofrohen edhe në disa institucione publike të nivelit primar në QKMF ku ekzistojnë shërbime të maternitetit dhe disa shërbime tjera specialistike si dhe në disa poliklinika në sektorin privat.

Kujdesi Dytësor Shëndetësor (KDSH) pos kapaciteteve stacionare ofrohet edhe përmes Qendrave të Shëndetit Mendor të Bazuara në Bashkësi (QSHMBB) ku shërbimet i ofrohen klientëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Mbrojtjen terciare në nivelin nacional e ofrojnë Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) dhe Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës (QKUSK) në kuadër të së cilave funksionojnë klinikat dhe institutet.

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut me njësitë e veta ofron shërbime të transfuzionit të gjakut dhe produkteve të tij në tërë territorin e Kosovës.

Kujdesi shëndetësor për të punësuarit realizohet përmes Institutit Kombëtar të Mjekësisë së Punës dhe institucionet e ngritura pranë organizatave të mëdha punuese dhe në kuadër të QKMF-ve.

Shëndetësia publike realizon aktivitetet e veta përmes Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe 6 qendrave rajonale të shëndetit publik.

Sqarim plotësues 1:

Kujdesi stomatologjik ofrohet në nivelin tretësor, në Qendrën Klinike Universitare Stomatologjike të Kosovës, në nivelin sekondar në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (mjek specialistë të stomatologjisë, si dhe në nivelin parësor nga mjekët stomatolog.

Analiza e Veprimtarisë Shëndetësore në Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH) për vitin 2016

Kujdesi parësor shëndetësor është gur themeli i sistemit shëndetësor pasi aty ishte dashur të plotësohen 80-90% të nevojave të mbrojtjes shëndetësore që identifikohen në kontaktin e parë të popullatës me shërbimin shëndetësor, duke përfshirë parandalimin, mjekimin dhe rehabilitimin. Një funksion i rëndësishëm i KPSH është edhe referimi drejtë niveleve më të larta të sistemit shëndetësor me qëllim të ruajtjes së integritetit të kujdesit unik shëndetësor.

Rrjeti i institucioneve në KPSH

Institucionet që ofrojnë kujdes primar shëndetësor janë: 28 Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), 183 Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF), dhe 191 Ambulanta të mjekësisë familjare. Në kuadër të QKMF ekzistojnë 15 maternitete jashtë spitalore.

**Sqarim plotësues 2:**

Rrjeti publik i KPSH përbëhet nga gjithsej 429 institucion, nga të cilat secila komunë e Kosovës ka Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) si njësi kryesore, me njësi të saj përbërëse: Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF).

**Burimi: MSH, 2019**

Kuadri në nivelin parësor sipas profileve në Kosovë për vitin 2016

Në kujdesin parësor shëndetësor për vitin 2016 sipas të dhënave që janë raportuar janë të punësuar gjithsej 5 358 punëtorë, prej të cilëve mjekë 1087 (20.3%), stomatologë 296 (5.5%), farmacistë 7(0.1%), teknik/infermier shëndetësor 3078 (57.4%), bashkëpunëtorë shëndetësor 44 (0.8%) dhe staf jo mjekësor 846 (15.8%).

Numri i banorëve në një mjek është 1 587 që i afrohet normativit të dhënë për Mjekësi Familjare. Sipas komunave ka variabilitet nga 845 në Obiliq deri në 6 993 banorë në një mjek në Novobërdë.

Në një stomatolog në KPSH në Kosovë ka 5 830 banorë. Numri më i madh i banorëve në një stomatolog ka qenë në Klinë 39 759. Numri i banorëve në një infermier në nivel Kosove është 561 dhe ka variacione nga 806 në Rahovec deri në 370 në Kamenicë.

Sipas komunave farmacistët e raportuar janë kuadër deficitar, raporti në mes të infermierëve dhe mjekëve është 3dhe më i larti është në Novobërdë ku në një mjek kemi 9 infermierë dhe më i ultë në Fushë Kosovë ku në një mjek kemi 2 infermier.

Indikatorët e mbulimit, indikatorët e vëllimit të punës në KPSH

Në KPSH janë realizuar gjithsej 3,688,571 vizita te mjeku, 384,655 vizita te stomatologu dhe 6,006,009 vizita te punëtorët tjerë shëndetësorë.

Ngarkesa mesatare ditore te mjeku është 12.1 vizita. Sipas komunave ngarkesa më e lartë ishte në Podujevës me 43.6 vizita ndërsa më e ultë është në komunën e Kamenicës me 0.7 vizita në ditë.

Ngarkesa mesatare ditore te stomatologu është 4.6 vizita. Sipas komunave ngarkesa më e lartë është në Podujevës me 37.4 vizita ndërsa më e ultë është në komunën e Kamenicës me 0.3 vizita në ditë ndërsa në 5 komuna s'ka fare stomatolog.

Ngarkesa mesatare ditore te infermieri është 7.0 vizita. Sipas komunave ngarkesa më e lartë është në Shtime me 20.1 vizita ndërsa më e ultë është në komunën e Kamenicës me 0.5 vizita në ditë.

Për kokë banori janë realizuar mesatarisht 2.1 vizita te mjeku, në vit. Sipas komunave numri më i lartë i vizitave për kokë banori është në Podujevë 8.0 ndërsa më e ulte është në komunat Obiliq dhe Novobërdë me 0.6 vizita në vit.

Për kokë banori janë realizuar mesatarisht 0.2 vizita te stomatologu në vit.

Morbiditeti në shërbimin e KPSH

Sipas klasifikimit të dhjetë ndërkombëtar (KNS 10) në morbiditetin e KPSH-së, numri më i madh i sëmundjeve të regjistruara është ai i grupit të X ( Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes me 142 357 raste (32.58%) pastaj vijnë Gr. XI (Sëmundjet e sistemit të tretjes me 57 941 raste 13.26 %. Pjesëmarrja më e ulët është në grupin e XVI (Gjendjet e caktuara që rrjedhin nga periudha perinatale) me 161 raste (0.03%).

#### Analiza e Kujdesit Dytësor Shëndetësor (KDSH)

Në Kosovë institucionet bazë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në nivelin dytësor të kujdesit shëndetësor janë spitalet e përgjithshme duke ofruar mjekimin stacionar (me shtrirje të pacientëve), si dhe shërbimet specialistike jashtë spitalore.

Spitalet e përgjithshme në Kosovë janë institucione shëndetësore publike të cilat kryejnë shërbime të nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor, duke ofruar kujdes specialistik pacientëve spitalorë dhe shërbime specialistike ambulatorë.

Shërbime specialistike ambulatorë dhe stacionare popullatës i ofrohen edhe në disa institucione publike të nivelit primar në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare ku ekzistojnë Shërbime të Maternitetit dhe disa shërbime tjera specialistike, si dhe në disa Poliklinika në sektorin privat.

Kujdesi dytësor shëndetësor (KDSH) pos kapaciteteve stacionare ofron shërbime në sferën e shëndetit mental përmes Qendrave të shëndetit mendor të bazuara në bashkësi (QSHMBB).

Në Kosovë ekzistojnë këto spitale të përgjithshme në Prizren, në Pejë, në Gjiilan, në Gjakovë dhe në Mitrovicë, në Ferizaj dhe në Vushtrri.

#### Kuadri shëndetësor në spitalet e përgjithshme të Kosovës

Në vitin 2016 në spitalet e përgjithshme të Kosovës kanë qenë të punësuar gjithsej 446 mjekë, 115 bashkëpunëtorë shëndetësorë dhe jo shëndetësorë .

Në spitalet e përgjithshme të Kosovës në vitin 2016 kanë qenë të punësuar gjithsej 1015 infermierë.

#### Indikatorët e mbulimit, vëllimit dhe kualitetit të punës në spitalet e përgjithshme të Kosovës

Në Spitalet e përgjithshme të Kosovës sipas raporteve të gjeneruara në IKSHPK, në vitin 2016 janë raportuar gjithsej 1 952 shtretër. Numri më i madh i shtretërve ka qenë në repartet e Internos me gjithsej 267 shtretër (13.7 %) nga numri i tërësishëm i kapaciteteve spitalore të nivelit dytësor, ndërsa numrin më të vogël e kanë pasur repartet e Dermatovenerologjisë 17 shtretër (0.9%) dhe salla e lindjes 8 shtretër (0.4%). Në spitale kanë qenë të shtrirë gjegjësisht janë trajtuar 82 081 pacientë.

Raporti të shtrirë për mjek (ngarkesa ditore) në spitalet e përgjithshme, më i larti ka qenë në spitalin e Gjakovës 4.2 pason spitali i Pejës me 3.6 dhe më i ultë ka qenë në spitalin e Ferizajit me 0.5.

Numrin më të madh të pacientëve e ka pasur reparti i Akusherisë 13 082 (15.9% nga numri i tërësishëm i pacientëve të hospitalizuar në spitalet e përgjithshme) ndërsa numrin më të vogël të pacientëve reparti i Dermatovenerologjisë me 171 ose 0.2 %.

Sa i përket të vdekurve në spitale, sipas reparteve numri më i madh i të vdekurve është regjistruar në repartin Internistik 321 (34.1%).

Shfrytëzimi i kapacitetit spitalor në nivel Kosove është 55.3 %, me variacione prej 118.6% në repartin e sëmundjeve infektive, 86.4% në repartin e Krahërorit, ORL 72.5 %, në njësinë koronare 68.7% dhe në repartin Dermatovenerologjik 33.4%.

Numri mesatar i operacioneve për mjek në nivel Kosove është 36, ndërsa sipas reparteve numrin më të lartë të operacioneve për mjek e kishte reparti i Kirurgjisë me 125, pason reparti i ORL-së me 114 operacione për mjek dhe numrin më të ulët e kishte reparti Gjinekologjik me 28 operacione për mjek.

Mjekimi mesatar në spitalet e përgjithshme është 4.7 ditë, me variacione në Psikiatri 14.9 ditë, repartin e Krahërorit 13 ditë, më së paku në Neonatologji (inkubator) 2.1 ditë dhe Kujdesin intensiv Kirurgjik 3.2 ditë.

Ngarkesa ditore për mjek në nivel Kosove ishte 2.3 pacientë ndërsa ngarkesa ditore për infermier është 1.0.

Mortaliteti spitalor sipas reparteve, më i lartë ishte në repartin e Neurologjisë me 86.7 ‰ dhe Kujdesin Intensiv Kirurgjik 62.0 ‰.

Mortaliteti spitalor në nivel Kosove është 11.5‰, më i larti në spitalin e Pejës 16.6 ‰ dhe më i ulëti në spitalin e përgjithshëm në Ferizaj 0.5 ‰ (Tab.14).

#### Morbiditeti në kujdesin dytësor shëndetësor (KDSH)

Tri grupet më të shpeshta të sëmundjeve të regjistruara në spitalet e përgjithshme të Kosovës gjatë vitit 2016 ishin: Gr. IX - Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut (I00-I99) me 16 378 raste (14.69 % nga të gjitha rastet e regjistruara të sëmundjeve në KDSH), Gr X - Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes (J00-J99) me 15 786 raste (14.15 %) të gjitha rasteve dhe Gr IX- Lëndimet, helmimet dhe disa nga pasojat tjera të shkaktuara nga faktorët e jashtëm(S00-T98) me 9 583 raste (8.59%).

#### Kujdesi tretësor shëndetësor

Kujdesi tretësor shëndetësor ngërthen në vete shërbimet mjekësore specialistike të nivelit më të lartë të gjitha institucioneve shëndetësore, ku funksioni i këtyre të fundit përfshin dhe edukimin në Fakultetin e Mjekësisë për studimet bazike, pasdiplomike dhe kërkime shkencore relevante. Në kuadër të KTSH-së mungojnë të dhënat për morbiditet.

#### Kuadri shëndetësor dhe jo shëndetësor në KTSH

Në vitin 2016 në KTSH kanë qenë të punësuar gjithsej 3 097 punëtorë, prej tyre 597 mjekë (19.3% nga numri i tërësishëm i të punësuarve), stomatologë 62 (2.0%), farmacistë 10 (0.3.%), infermierë 1 837 (59.3%), bashkëpunëtorë shëndetësor 14 (0.5%) dhe punëtorë jomedicinal 576 (18.6%).



Numri i gjithmbarshëm i mjekëve specialist në QKUK ishte 535, prej tyre numri më i madh i mjekëve ishte i koncentruar në klinikën e Gjinekologjisë dhe Akusherisë me 56 mjekë (10.5%), klinikën e Anesteziologjisë me 45 mjekë (8.4%), ndërsa numri më i vogël i mjekëve është raportuar në klinikën Maksillofaciale dhe QTK me nga 3 mjekë (0.6%).

Numri i gjithmbarshëm i infermierëve në QKUK ishte 1 667, prej tyre numri më i madh i infermierëve ishte i koncentruar në klinikën e Gjinekologjisë me Akusheri me 222 (13.3%) infermierë, pastaj klinikën e Anesteziologjisë me 161 (9.7%) infermierë. Numri më i vogël i infermierëve është raportuar në klinikën e Reumatologjisë me 10 (0.6%) infermierë dhe në Mjekësinë Nukleare me vetëm 9 infermierë (0.5%).

**Indikatorët e mbulimit, vëllimit dhe kualitetit të punës në QKUK**

Në QKUK sipas raporteve të gjeneruara në IKSHPK në vitin 2016 janë raportuar gjithsej 1 898 shtretër, 504 826 ditë mjekimi.

Numri më i madh i shtretërve ka qenë në repartet e klinikës Obstetrike Gjinekologjike me gjithsej 399 shtretër (21.0%) ndërsa numrin më të vogël e ka pasur Klinika e Kardiokirurgjisë dhe Klinika e Fiziatriisë me gjithsej 14 shtretër (0.7%) .

Numri i pacientëve të hospitalizuar në QKUK ishte 96 828 dhe në raport me mjekët klinikë kemi 180 pacientë për një mjek.

Ngarkesa mesatare ditore e mjekut (pacientë të shtrirë për mjekë) në QKUK ishte 1.9. Sipas klinikave ngarkesa më e lartë ishte në klinikën Infektive 7.5, pastaj në klinikën e Neonatologjisë 5.3 dhe në Klinikën e Hematologjisë 5.2, ndërsa ngarkesa më e vogël ishte në Klinikën e Fiziatriisë 0.6 dhe në Klinikën e Anesteziologjisë 0.4.

Ngarkesa mesatare (ditore) e infermierit ishte 1.2. Ngarkesa më e lartë ishte në Klinikën e ORL me 3.2 dhe në Kraherorit 2.5. Ndërsa ngarkesa më e vogël ishte në Klinikën e Anesteziologjisë 0.2 (Tab.20).

**(Burimi: Analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës në Kosovë - 2016; IKSHPK)**

## **Shpenzimet për kujdesin shëndetësor**

Raporti i Shpenzimeve Shëndetësore (hartuar në software HAPT) në Kosovë ka filluar të përpilohet nga viti 2014. Agjensioni i Statistikave të Kosovës raporton që nga viti 2009, dhe i njëjti raportohet në Komisionin Evropian, EUROSTAT, MCC, ODEC dhe OKB.

Raporti për llogaritë nacionale të shëndetësisë hartohet sipas metodologjisë SHA 2011, edhe pse në Kosovë ende nuk i shfrytëzojmë të gjitha kodet, pasi që struktura e shpenzimeve në shëndetësi akoma nuk është specifikuar deri në detajet më të vogla (shembull: shpenzime për barna për çdo pacient spitalor apo ambulator, sipas moshës, gjinisë dhe regionit). Po ashtu, një pjesë e sektorit privat ende nuk raporton sipas kodeve të kërkuara nga metodologjia SHA 2011. Akoma nuk kemi asnjë indikator për shpenzimet e banorëve për trajtime mjekësore jashtë vendit, që e konsiderojmë sfidë në paraqitjen e të dhënave të plota për shpenzimet shëndetësore vjetore.

Kosova nuk mund të krahasohet as me vendet e rajonit, në kuptim të përqindjes së GDP – së për shëndetësi, psh. shtetet e rajonit si Mali i Zi ose Maqedonia e veriut investon rreth 7.94%, ndërkaq Kosova 4.47%.

Kosova është ndër vendet e rajonit / Evropës me përqindjen më të vogël të GDP – së të shpenzuar për shëndetësi në krahasim me vendet e tjera, por që ka tendencë përmirësimi në shpenzimet e sektorit publik për shëndetin e popullatës.


**Tabela 1: Indikatorët kyç, 2017 dhe 2018**

	Population	Gross domestic product	
		Total (billion EUR)	Per capita (EUR)
		2017	
EU-28	512 379	15 383.1	30 000
Montenegro	622	4.3	6 900
North Macedonia	2 075	10.0	4 800
Albania	2 870	11.6	4 000
Serbia	7 001	39.2	5 600
Turkey	80 811	753.9	9 400
Bosnia and Herzegovina <sup>(1)</sup>	3 503	15.3	4 400
Kosovo	1 799	6.4	3 600

(1) Gross domestic product: 2016.

Source: Eurostat (online data codes: [demo\\_gind](#), [nama\\_10\\_gdp](#), [nama\\_10\\_pe](#), [nama\\_10\\_pc](#) and [demo\\_gind](#))

**Grafiku 3: Shpenzimet publike për shëndetësi, në raport me GDP, 2007 dhe 2017**



Note: Montenegro, North Macedonia and Bosnia and Herzegovina, not available.

(1) 2007: not available. 2016 (estimate) instead of 2017.

(2) Source: Eurostat (online data codes: [hlth\\_sha11\\_hf](#) and [nama\\_10\\_gdp](#))

Kosova vlerësohet të ketë shpenzime shëndetësore për kokë banori pothuajse dymbëdhjetë herë më pak se niveli i vendeve evropiane (1,990 euro – burimi Eurostat, publikim 2017), duke shpenzuar ekuivalentin prej 158 euro/vjetore për kokë banori (viti 2017), për secilin banor rezident në Republikën e Kosovës.

Shpenzimet totale shëndetësore së bashku me shpenzimet kapitale ishin 285 milionë euro në Kosovë në vitin 2017.

Tabela 2: Buxheti publik për shëndetësi, si pjesë e buxhetit vjetor të shtetit

	Buxheti total	Buxheti i sektorit shëndetësor
Shumë	2,085,994,000	180,362,070
%	100	8.65

Burimi : MF, Ligji i buxhetit 2017

Shpenzimet shëndetësore aktuale dhe publike shprehur në përqindjen e GDP-së Për dallim nga vendet e tjera Qeveria e Kosovës me 2.83 % investon përqindjen më të vogël të GDP-së vendore.

Shumica e vendeve të rajonit shpenzojnë për kujdesin shëndetësor mesatarisht 6% të GDP Ky fakt indikon se shëndetësia nuk ka qenë prioritet, dhe nuk i plotëson nevojat e popullatës, përkundër investimeve kapitale vendore që po bëhen në vendin tonë.

Tabela 3: Shpenzimet për shëndetësi, si % e GDP -së

Sektori	Shpenzimet (Euro)	% e GDP
Publike	180,362,070	2.83
Private	105,000,000	1.65
Totale	285,362,070	4.47

Burimi : MF, Ligji i buxhetit 2017, LLSH Kosovë 2017)


Duhet të kemi parasysh se pos investimeve të qeverisë, burimi kryesor i financimit është pagesa nga xhepi (OOP- out of pocket) e banorëve të vendit. Kjo do të thotë se banorët financuan drejtpërsëdrejti nga xhepat e tyre rreth 40% të shpenzimeve të kujdesit shëndetësor në vitin 2017 (bazuar në të dhënat të cilat janë në dispozicion) .

Tabela 4: Shpenzimet për shëndetësi, si % sipas sektorit

Sektori	Shpenzimet (Euro)	%
Publike	180,362,070	63.07
Private	105,000,000	36.93
Totale	285,362,070	100

Burimi: MF, Ligji i buxhetit 2017, LLSH Kosovë 2017)

Graf. 4: Përqindja e GDP për shëndetësi, krahasim 2017 (burimi: Eurostat)




OBSH-ja paralajmëron se pjesa e shpenzimeve shëndetësore të parave të xhepit (OOP-it) ndërmjet 15-30% të shpenzimeve aktuale shëndetësore i referohet politikave të forta pro-të varfërve për të arritur një mbrojtje të mirë financiare . Secili person në Kosovë ka shpenzuar në shëndetësi mesatarisht 58.3 euro në 2017, që është rreth 3% e konsumit vjetor të ekonomive familjare.

Në vitin 2017, pjesa e burimeve të jashtme për shpenzimet shëndetësore ishte rreth 6.7% e shpenzimeve aktuale shëndetësore. Kosova merr mesatarisht më shumë ndihmë nga pjesa tjetër e botës (remitencat) nëse krahasohet me vendet fqinje apo ato vende të rajonit evropian të cilët gjithashtu kanë financuar një pjesë të kujdesit shëndetësor nga resurset e jashtme-remitencat në vendin tone (Anketa e Ekonomive familjare, ASK 2018).

Jetëgjatësia dhe shpenzimet aktuale shëndetësore për kokë banori, 2017 (Kosova 2018) / Burimi i të dhënave: OECD/ - Është treguar se jetëgjatësia korrespondon me nivelin e shpenzimeve shëndetësore për kokë banori. Jetëgjatësia në lindje është më e larta në Spanjë dhe Zvicër (83 vjet secila) në Rajonin Evropian.

Grafiku 5: Life expectancy at birth, 2007 and 2017 (years)



Note: Bosnia and Herzegovina, not available.

(1) Break in series.

(2) 2007: not available. 2016 (provisional) instead of 2017.

(3) 2007: not available.

(4) 2009 instead of 2007.

Source: Eurostat (online data code: [demo\\_mlexpec](#))

Shpenzimet shëndetësore të këtyre shteteve janë gjithashtu relativisht të larta. Jetëgjatësia është më e ulta në Turkmenistan (66), ku edhe shpenzimet shëndetësore për kokë banori janë mjaft të ulëta. Në Kosovë, mesatarja e jetëgjatësisë qëndron në 71 vjet për 2016-2017. Por sipas ODEC-ut me një rritje prej 10% në shpenzimet shëndetësore për kokë banori në terma realë do të rritë mesatarisht jetëgjatësinë prej 3.5 muaj. Megjithatë, nuk është vetëm shpenzimi, por edhe mënyra se si përdoren

burimet shëndetësore , që e bën ndryshimin në jetëgjatësinë e popullatës rezidente të Kosovës.

### Shpenzimet e sektorit publik

Sektori publik shëndetësor në Kosovë përbëhet nga Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës, Kujdesi Parësor Shëndetësor, dhe dikasteret tjerë qeveritar të cilët sigurojnë shërbime shëndetësore.

Struktura e planifikimit buxhetor dhe raportimit të shpenzimeve bëhet sipas kategorive buxhetore kryesore: Paga & Mëditje, Mallra & shërbime, Subvencione & transfere, Investime kapitale, dhe shpenzime komunale.

Gjatë vitit 2017, shpenzimet publike për shëndetësi arrijnë shumën prej 180,362,069.83 Euro. Shpenzimet e ndara sipas organizatave buxhetore publike, kanë qenë si vijon:


Tabela 5: Shpenzimet e sektorit publik, sipas organizatave buxhetore

MSH	57,567,776.19
SHSKUK	70,553,112.44
KPSH	52,241,181.20
<b>Total</b>	<b>180,362,069.83</b>

Tabela 6: Shpenzimet e sektorit publik

Revenues of health care financing schemes		FS.1.1	FS.2	All FS
Financing schemes		Internal transfers and grants	Transfers distributed by government from foreign origin	
HF.1.1.1	Central government schemes	165,785,204.0	235,584.0	166,020,788.0
HF.1.1.2	State/regional/local government schemes	714,834.3	307,041.2	1,021,875.5
<b>All HF</b>		166,500,038.3	542,625.2	167,042,663.5

## Grafiku 6: Shpenzimet e sektorit publik




## Tabela 7: Shpenzimet e sektorit publik, Investime kapitale

Capital Account	Health care providers	HP.1 Hospitals	HP.3 Provider s of ambulat	HP.6 Provider s of preventi	HP.7 Provider s of health	All HP	Share of HK
HK.1.1.1.1	Residential and non-residential buildings	1,652,818.1	5,523,138.2	1,778,437.0	2,886,930.1	11,841,323.4	78.4
HK.1.1.2.1	Medical equipment	689,745.6	603,565.5	783,624.7	5,180.0	2,082,115.8	13.8
HK.1.1.2.2	Transport equipment		471,470.0			471,470.0	3.1
HK.1.1.3.1	Computer softëare and databases	708,285.5				708,285.5	4.7
HK.1.2	Changes in inventories		15.5			15.5	0.0
All HK		3,050,849.2	6,598,189.2	2,562,061.7	2,892,110.1	15,103,210.3	
Share of HP		20.2	43.7	17.0	19.1		

Currency: Euros (EUR)

## Grafiku 7: Shpenzimet e sektorit publik, Investime kapitale



### Shpenzimet shëndetësore private

Në Republikën e Kosovës, sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, kemi 27 spitale private dhe 1592 institucione private shëndetësore, prej të cilave: 114 Poliklinika, 141 laboratore, 43 kabinete, dhe 1294 ambulanca specialistike;

Të dhënat të cilat ka qenë e mundur të sigurohen për shpenzimet e sektorit privat, përfshijnë vlerën e barnave të importuara në vend për vitin 2017, barna këto të cilat janë blerë nga xhepi i qytetarit, sepse nuk ka akoma mundësi të rimbursimit të barnave. Pastaj, janë siguruar të dhënat për shpenzimet e kompanive të sigurimit shëndetësor vullnetar, shpenzimet e qendrave rehabilituese private në vend dhe donacionet.

Të dhëna për mjetet e shpenzuara nga qytetarët për trajtimin privat në institucionet private shëndetësore në vend; dhe trajtimin privat në institucionet private shëndetësore jashtë vendit nuk kemi pasë mundësi të i sigurojmë, sepse nuk ka mekanizëm për mbledhje të këtyre të dhënave, dhe as vlerësim (ekstrapolim) objektiv.

Tabela 8 – Shpenzimet shëndetësore private, 2017

Shpenzime nga xhepi - barna dhe materiale mjekësore	67,248,090.84
Qendra rehabilitimi	7,747,549.80
Kompanitë e sigurimit shëndetësor vullnetar	16,996,000.00
Donatorët	11,680,730.21
Total	103,672,370.84

Tabela 9: Shpenzimet e familjeve për barna dhe materiale mjekësore

Financing schemes		HF.3.1	All HF
Revenues of health care financing schemes		Out-of-pocket excluding cost-sharing	
FS.6.1	Other revenues from households n.e.c.	73,833,508.2	73,833,508.2
All FS		73,833,508.2	73,833,508.2

Currency: Euros (EUR)

Used data sources:


Households

Out of Pocket Expenditures - medicines and medical supplies

Rehabilitation Centres

Banja e Kllotit, Banja e Pejës, Nena Naile

### Grafiku 8: Shpenzimet e familjeve për barna dhe materiale mjekësore



### Grafiku 9: Shpenzimet e qendrave të rehabilitimit - banjat




Tabela 10: Shpenzimet e qendrave të rehabilitimit - banjat/ Kapitallet



Health care providers	HP.4	All HP
Capital Account	Providers of ancillary services	
HK.1.1.2.1 Medical equipment	1,162,132.5	1,162,132.5
All HK	1,162,132.5	1,162,132.5

Currency: Euros

Used data sources:

Rehabilitation centers Banja e Kllokotit, Banja e Pejës, Nena Naile

Grafiku 10: Shpenzimet e qendrave të rehabilitimit – banjat/ Kapitallet




Tabela 11: Shpenzimet e kompanive të sigurimit shëndetësor vullnetar


Financing schemes	HF.2.1.nec	All HF
Revenues of health care financing schemes	Unspecified voluntary insurance health schemes (n.e.c.)	
FS.5.1 Voluntary prepayment from individuals/households	16,996,000.0	16,996,000.0
All FS	16,996,000.0	16,996,000.0

Currency: Euros (EUR)

Used data sources:

Insurances Private Insurance Company

Graf 11: Shpenzimet e kompanive të sigurimit shëndetësor vullnetar



## Donacionet

Në këtë grup investimesh janë përfshirë të gjitha të dhënat nga donatorët gjatë vitit 2017, të cilat kanë qenë të dedikuara për sektorin publik, duke mbuluar edhe kontraktimin social për shërbime të veçanta, asistues për MSh – në. Tabela në vijim paraqet kontributin e donatorëve:

Donatori	Përfituesi	Shuma
Government of Japan	Ministry of Health	10,292.60
Government of Japan	Municipality Kacanik	52,715.00
Government of Japan	Municipality Dragash	72,880.00
Government of Japan	Municipality Klina	68,229.00
Italian Cooperation	MoH and UHCSK	342,840.00
Luxembourg	Ministry of Health	1,712,510.41
Sweden	University Clinical Centre of Kosova	102,448.00
Swiss Agency for Development and Cooperation	National Institute of Public Health of Kosova	1,541,111.41
Swiss Agency for Development and Cooperation	Ministry of Health	443,734.47
The Global Fund	Community Development Fund	910,787.58
The Global Fund	Community Development Fund/MoH	579,664.99
TIKA		0.00
Community Development Fund/The Global Fund	Ministry of Health	28,300.50
World Health Organization		49,314.87
World Health Organization - In kind		5,565,901.37
UNFPA		200,000.00
Gjithsej		11,680,730.21

Tab 12: Shpenzimet nga donacionet


Financing schemes	HF.4.2.2	All HF
Revenues of health care financing schemes	Other schemes (non-resident)	
FS.7.1.3 Other direct foreign financial transfers	11,656,554.4	11,656,554.4
All FS	11,656,554.4	11,656,554.4

Currency: Euros

Used data sources:

Donors Italian Cooperation, Luxembourg, Sëeden, Sëiss, The Global Fund, ËHO, UNFPA, Government Of Japan

Grafiku 12: Shpenzimet nga donacionet



Shënim: UNFPA e ka donacioni në US dollarë, prandaj ka një dallim të vogël në shumën totale.